



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 6390/2022  
Data: 10.08.2022

**PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e shtatë -VII- për vitin 2022 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 19.07.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetari i Komunës), **Nexhmedin Daci** (Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Kimete Kuka –Hasallari** (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh për Administratë), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Sevime Bajrami** (Kryesuese e Komisionit të Aksionarëve). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2022.
3. Raporti i auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2021.
4. Plani i veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2021.
5. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2022.
6. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2022 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
7. Informatë për sektorin e emergjencave.
8. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- përveq pikave të rendit të punës kemi edhe dy kërkesa për pika shtesë, Kërkesë për rialokim dhe transfer të mjeteve nga kategoritë ekonomike të shpenzimeve kapitale dhe mallra dhe shërbime. Propozim vendim për miratim të projektit të ri kapital. Për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- kërkoj që të hynë si pikë e rendit të punës raport për çështjen e ujit në fshatin Gorancë.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA RENDI I PUNËS**

Procedojmë me këtë rend të punës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2022.
3. Raporti i auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2021.
4. Plani i veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2021.
5. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2022.
6. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2022 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
7. Informatë për sektorin e emergjencave.
8. Kërkesë për rialokim dhe transfer të mjeteve nga kategoritë ekonomike të shpenzimeve kapitale dhe mallra dhe shërbime.
9. Propozim vendim për miratim të projektit të ri Kapital.
10. Raport për çështjen e ujit në fshatin Gorancë.
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2022.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- buxheti i miratuar për vitin fiskal 2022 është në shumë prej 2,759,758.00 €. Në kategorinë Paga dhe shtesa shpenzimi është në shumë prej 845,636.78€ ose 48.15%, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 97,003.58 € apo 25.13%, në kategorinë ekonomike shërbime komunale shpenzimi është në shumë prej 29,238.28 € apo 43.19%, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 28,532 € apo 35.67%, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 49,999.89 € apo 10.99% .Totali i shpenzimit për periudhën Janar - Qershor të vitit 2021 është në shumë prej 1,050,410.53 € apo 38.06 %. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsejtë 157,791.86 € të hyra vetanake për periudhën Janar- Qershor 2021 apo 41.3% e planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2021 kemi një rënie prej 34,720.24 € apo për 18%, (duke pasur parasysh që planifikimi i të hyrave për vitin 2022 është në shumë prej 381,347 € ndërsa për vitin 2021 është 288,624 €). Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Refet Kalisi** thekson:- te shpenzimet kapitale shumë pak është shpenzuar buxheti.

**Nexhmedin Daci** thekson:- te shpenzimet kapitale në aspekt të pagesave jemi mbrapa ndërsa projektet janë duke u realizuar në teren.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI FINACIAR PËR PERIUDHËN JANAR –QERSHOR 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND



### **3. Raporti i auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2021.**

**Kryesuesi** thekson:-për këtë pikë të rendit të punës.

**Lindita Ballazhi** thekson:- kemi pasur nëntë rekomandime dhe një prej tyre është e përsëritur. Klasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike jo përkatëse. Mangësi në shënimet shpjeguese të pasqyrave vjetore financiare. Parregullsi në procedurat e rekrutimit të personelit. Mangësi në vlerësimin e tenderëve. Parregullsi në procedurat e subvencionimit të projekteve. Nënshkrimi i kontratës publike pa zotim paraprak të mjeteve në SIMFK, si dhe lëshimi i urdhër blerjeve pas skadimit të kontratave. Parregullsi në menaxhimin e pasurisë jofinanciare. Rritje e llogarive të arkëtueshme. Vonesa në regjistrim dhe pagesa të obligimeve. Nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Sherif Berisha** thekson:- a ka ende borxhe nga vitet tjera.

**Lindita Ballazhi** thekson:- ka borxhe edhe të vitit 2018 dhe shpenzimet bëhen me buxhetin e vitit 2022.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim ; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA RAPORTI I AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM PËR KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **4. Plani i veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2021.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe i kemi dhënë shpjegimet për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit për vitin 2021. Nëse keni ndonjë sugjerim mund të parashtroni.

**Refet Kalisi** thekson:- rekomandimet të cilat janë dhënë nga zyra e auditorit është problem për me i realizuar por brenda mundësive shpresoj që t'i realizoni.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA PLANI I VEPRIMIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR ADRESIMIN E RE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **5. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2022.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sevdi Dernjani** thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Refet Kalisi** thekson:- në opinion diskutohet vazhdimisht për çështjen e substancave narkotike, mirëpo konkret nuk e kam parë askënd dhe është mirë t'i kushtojmë rëndësi kësaj çështje. Është mirë të ju bëhet test nxënësve dhe profesorëve në mënyrë që ta dimë se ku jemi.

**Kryesuesi** thekson:- këtë dukuri nuk duhet ta fshehim dhe nuk duhet t'i bëjmë vetës qef se gjoja është krejt në rregull. Duhet të merren masa për me parandaluar deri sa nuk është bërë vonë . duhet nëpër shkolla me bërë kontroll , pastaj kamerat janë të vendosura por duhet ti monitorojmë.

**Sherif Berisha** thekson:- nuk është mirë të bëhet vetëm temë diskutimi por duhet të ndërmerren edhe hapa konkret. Duhet të kontribojmë si asamblistë dhe si qytetarë sepse kjo dukuri e substancave narkotike është për me u shqetësuar. Pak a shumë mund të kemi pikë orientimi por organet e sigurisë kamerat i kanë.

**Sevdi Dernjani** thekson:- në të gjitha punëtoritë që kem marr pjesë i kemi diskutuar këto çështje dhe me shpresë zyrtare ju kemi drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme për shtimin e numrit të policëve në lokalitet. Komuna nuk mund të ndërmerr ndonjë veprim për këtë çështje për shkak se janë organet kompetente për këto raste.

**Sherif Berisha** thekson:- kamerat nuk e di si janë të vendosura sepse tash është fluksi më i madh i mërgimtarëve dhe po shihen si po parkohen veturat dhe këto çështje organet e rendit duhet t'i kenë parasysh.

**Sevdi Dernjani** thekson:- mund të ju informojë se kamerat nuk i ka më në mbikëqyrje komuna për shkak se nuk jemi të autorizuar me ligj me i pasur kamerat e pronave publike në mbikëqyrje . Në momentin që e kemi pranuar detyrën e kemi njoftuar kompaninë përgjegjëse për me bërë shkëputjen e kamerave dhe kjo kompetencë është e policisë.

**Hisni Luri** thekson:- janë organizuar disa punëtori për çështjen e dukurive negative por edhe njësitë e policisë anti drogë ka qenë në qytetin tonë. Si institucion jemi për me u bërë bashkë dhe me parandaluar këtë dukuri negative.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA INFORMATA PËR AKTIVITETET E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## **6. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2022 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sevime Bajrami** thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mundeni me parashtruar.

**Sherif Berisha** thekson:-si anëtarë komisionit të aksionarëve të N.P.L “Pastrimi” sh.a vërejtje kam që nuk po takohemi dhe është mirë që si kryesuese e komisionit të na ftoni në takim.

**Sevime Bajrami** thekson:- për shkak të angazhimeve të cilat i kam në drejtorin e financave nuk kam mundur me ju ftuar në takim por në të ardhmen të kemi takime.

**Nora Xhoni** thekson:- bartja e mbeturinave në mbrëmje a është duke shkuar mirë.

**Sevime Bajrami** thekson:- mirë është duke funksionuar.

**Refet Kalisi** thekson:- është mirë të bëhet auditim në kompani për shkak se nuk është bërë asnjë herë sepse auditimi i tregon të metat e kompanisë.



**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA RAPORTI FINANCIAR PËR PERIUdhËN JANAR-QERSHOR 2022 I NPL PASTRIMI SH A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### **7. Informatë për sektorin e emergjencave.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Arsim Dernjani** thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçant nuk kam.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA INFORMATA PËR SEKTORIN E EMËRGJENCAVE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### **8. Kërkesë për rialokim dhe transfer të mjeteve nga kategoritë ekonomike të shpenzimeve kapitale dhe mallra dhe shërbime.**

**Lindita Ballazhi** thekson:- kërkesë kemi parashtruar për rialokimi dhe transfer të mjeteve në kategorinë shpenzime kapitale në shumë prej 37,695.00 €, Pra, rialokimi dhe transferi mjeteve në total për komunën e Hanit të Elezit është në shumë prej 37,695.00 € nga fondi 21 sipas programeve/nën-programeve buxhetore. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA KËRKESA PËR RIALOKIM DHE TRANSFER TË MJETEVE FINACIARE NGA KATEGORIA EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE KAPITALE DHE MALLRA DHE SHËRBIME QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### **9. Propozim vendim për miratim të projektit të ri kapital.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- bëhet fjalë për rrugën Ramuk-Kroi i fshatit Paldenicë dhe shuma e projektit është 213,000.00 €. Këtë emërtim të projektit nuk e kemi në listën e projekteve kapitale dhe duhet të hynë si projekt i ri.

**Sevdi Dernjani** thekson:- në Ministri të Infrastrukturës i kemi prezantuar dy projekte shtrimin e rrugës me asfalt Gorancë- Krivenik dhe projektin e rrugës Ramuk-Kroi i fshatit Paldenicë por Ministria e Infrastrukturë e ka pranuar projektin e rrugës Ramuk-Kroi i fshatit Paldenicë. Është mirë që të votohet ky projekt dhe të përcillet për kuvend për shkak se është interes të komunitetit.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË RI KAPITAL QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## 10. Raport për çështjen e ujit në fshatin Gorancë.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sevdi Dernjani** thekson:- në Gorancë janë dy vend burime të ujit dhe nga dy vend burimet akumulohet uji në rezervarin kryesorë që është ndërtuar prej komunës dhe sipas institutit të shëndetësisë ai rezervar është jashtë standardeve që kërkohet prej institutit. Drejtorja e shërbimeve publike ka marr mas për ndërtimin e një shtëpize të vogël për klorifikimin e ujit. Sipas institutit të shëndetësisë kanë dal rezultate të cilat janë marr për mostrat e ujit. Burimi i Ujit që është në vendin e quajtur Sudonec është i pihem ndërsa burimi i ujit që në vendin e quajtur te Kisha ka dal që është jashtë parametrave normal. Të gjithë ata të cilët kanë qenë të infektuar e kanë marr trajtimin e nevojshëm. Të gjithë institucionet të cilat janë përgjegjëse ua kemi treguar gjendjen në komunën tonë, duke filluar me gjendjen aktuale të barnave dhe stafit shëndetësorë. Drejtorja për shërbime publike e ka hartuar një paramasë në shumë prej 40 000 € të cilën e kemi dërguar në Ministri të Pushtetit Lokal dhe Zëvendës Ministrit të Pushtetit Lokal ja kemi prezantuar si plan emergjent.

**Sherif Berisha** thekson:- gypat të cilët janë vendosur para se me u lëshuar burimi i ujit të Sodonecit a ju ka bërë dikush test.

**Sevdi Dernjani** thekson:- i kam parë të dy vend burimet dhe dyshimi ka qenë për burimin e ujit në Sodonec por kur të analizohet më shumë uji të Kisha është më në rrezik se uji në Sodonec dhe ato ditë ka pasur reshje të mëdha dhe ju e dini se i njëjti rast ka ndodhur edhe në Kaçanik me të njëjtat simptome dhe për atë nuk mundemi me dyshuar.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË RI KAPITAL QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## 11. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nora Xhoni** thekson:- si është gjendja e kovidit në komunën tonë se ka filluar me u rrit numri.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- kanë filluar me u rritur rastet dhe ditën e djeshme nga 26 testet të cilat janë bërë 11 prej tyre kanë dal pozitiv. Gjithsejtë i kemi 26 raste pozitive. Vaksina kemi por qytetarët nuk kanë shfaqur interesim për me i marr vaksinat.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:47.

**Procesmbajtësi**

**Avni Bushi**

